

AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

UDHËZIM

SANKSIONET FINANCIARE TË LIDHURA ME TERRORIZMIN, FINANCIMIN E
TERRORIZMIT DHE FINANCIMIN E PËRHAPJES SË ARMËVE TË DËMTIMIT NË
MASË

Përditësuar

Shtator 2025

PËRMBAJTJA	
SHKURTIMET	4
PËRKUFIZIME	6
HYRJE	10
Çfarë janë SSHM	10
Llojet e SSHM	10
SSHM në Lidhje me Terrorizmin dhe Financimin e Terrorizmit	11
SSHM në Lidhje me Përhapjen e ADM.....	11
VENDOSJA E SSHM.....	13
DETYRIMET PËR ZBATIMIN E SSHM	13
Detyrime të Përgjithshme	13
Shpallja në Listën Vendore	14
Shpallja në zbatim të rezolutave të KSKB.....	15
Zbatimi i SSHM.....	15
Detyrimet për Individët dhe subjektet raportuese pas njoftimit të shpalljes	17
Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë	17
Procesi i shpalljes sipas ligjit MSH.....	18
Detyrime për subjektet raportuese	19
Detyrimet e raportimit: Çfarë duhet të raportoni në AIF	19
Leja për qasje në fondet dhe pasuritë e ngrira.....	20
FONDE DHE PASURITË QË I NËNSHTROHEN NGRIRJES	21
MASAT PARANDALUESE DHE KOMUNIKIMI	23
Si ta përdorni këtë udhëzues	23
Cilësia dhe dobia e të dhënave	24
Procesi i apelimit: apelimi i një shpallje ose heqja e sanksioneve	25
PROCESI I HEQJES NGA LISTA	25
Kërkesë për heqje nga Lista Vendore	25
RAPORTIMI NË AIF	26
Ngrirje e përkohshme.....	28
LIDHJE TË RËNDËSISHME	28
Shtojca 1. Treguesit e financimit të terrorizmit dhe ADM.	30

SHKURTIMET

ADM	– Armët e Dëmtimit në Masë
AIF	– Agjencia e Inteligjencës Financiare
IF	– Institucion Financiar
KSKB	– Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
MSH	– Ligji Nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese në Republikën e Shqipërisë”,
LPPP/FT	– Ligj nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar
MKFT	– Ligj Nr.157/2013 “Masat kundër financimit të terrorizmit” i ndryshuar
PBJF	– Profesionet dhe Bizneset Jo-Financiare
PPP/FT	– Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
RPDK	– Republika Popullore Demokratike e Koresë
SSHf	– Sanksionet e Shënjestruara Financiare

Titulli	Versioni	Aprovuar në
Udhëzues për “Sanksionet financiare në lidhje me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë”	1	Maj 2020
Udhëzues për “Sanksionet financiare në lidhje me terrorizmin, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë”	2	Shtator 2025

PËRKUFIZIME

“Burime Ekonomike” Pasuri të çdo lloji, qofshin të luajjtshme apo të paluajjtshme, të trupëzuara apo të patrupëzuara, të cilat mund të përdoren për të siguruar fonde, mallra ose shërbime, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Mjete me natyrë fikse, siç janë anijet, avionët dhe automjetet.
- Inventarët e mallrave.
- Veprat e artit, bizhuteritë dhe ari.
- Mallrat duke përfshirë naftën, produktet e rafinuara, rafineritë modulare dhe materialet e lidhura, duke përfshirë kimikatet, lubrifikantët, mineralet ose burime dhe mallra të tjera natyrore.
- Armët dhe materialet e lidhura, lëndët e para dhe përbërësit që mund të përdoren për të prodhuar pajisje shpërthyesë të improvizuara dhe armë jokonvencionale.
- Patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit dhe format e tjera të pronësisë intelektuale.
- Pajisje, mobilje apo dhe instalime.
- Ofrimi i internetit dhe shërbimet e lidhura me të.

“Fonde” Çdo lloj pasurie pavarësisht nga vlera, natyra ose mënyra e fitimit të saj, qoftë elektronike apo dixhitale, qoftë brenda apo jashtë Shqipërisë, duke përfshirë çdo fitim ose interes mbi një pasuri të tillë që duhet paguar ose është shpërndarë plotësisht ose pjesërisht. Kjo përfshin monedhën vendase dhe të huaj, instrumentet financiare dhe tregtare, të paluajjtshme ose të luajjtshme, dhe pasuritë të trupëzuara apo të patrupëzuara dhe të gjitha të drejtat ose interesat e dhëna në to, aktet dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë për sa më sipër, duke përfshirë kreditë bankare, depozitat, urdhër pagesat postare apo bankare dhe letrat e kreditit.

Shembuj të fondeve janë si më poshtë:

- Të gjitha llojet e angazhimeve financiare si: borxhet dhe detyrimet e borxhit, kreditë bankare, depozitat, mandatet postare, mandatet bankare dhe letrat e kreditit, çeket, kërkesat për para, mandatet, urdhërpagesat, instrumentet e mbajtësit.
- Para në të gjitha monedhat, duke përfshirë monedhën virtuale dhe elektronike dhe instrumente të tjera pagese të bazuara në internet.
- Depozitat në institucione financiare ose subjekte të tjera dhe gjëndjet në llogari, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (1) llogari depozitash fikse ose afatgjata, (2) gjëndjet në llogaritë tregtare të aksioneve në banka, firma ndërmjetësimi ose llogari të tjera tregtare investimesh.
- Borxhet dhe detyrimet e borxhit, duke përfshirë borxhet tregtare, llogaritë e tjera të arkëtueshme dhe pretendimet nga palë të tjera.
- Letrat e kreditit, faturat e import eksportit, faturat e shitjes dhe dokumente të tjera që provojnë një interes në fonde ose burime financiare dhe çdo instrument tjetër të financimit të aktivitetit të import eksportit.

- Kapitali aksionar dhe interesa të tjera financiare.
- Polica të sigurimit dhe risigurimit.
- Aksione në pronësi të palëve të tjera.
- Letra me vlerë dhe instrumente të borxhit të tregtuara publikisht dhe privatisht, duke përfshirë aksionet, certifikata që përfaqësojnë letra me vlerë, obligacione, garanci, obligacione dhe kontrata të derivateve.
- Interesa, dividend ose të ardhura të tjera mbi ose vlera që grumbullohet nga ose krijohet nga pasuritë.
- Pasuri të Paluajtshme.

“Lista vendore” Lista e personave të shpallur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenin 15 të ligjit MKFT

“Mallra me përdorim të dyfishtë” Përfshijnë produkte dhe teknologji të cilat përdoren për qëllime civile por që mund gjejnë zbatim dhe për qëllime ushtarake.

“Përhapja e ADM” Bazuar në Rezolutën 1540 të KSKB-së, përhapja e ADM përkufizohet si — *prodhimi, blerja, posedimi, zhvillimi, eksporti, transportimi, ndërmjetësimi, transferimi, grumbullimi ose përdorimi i armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore dhe mjeteve të përdorimit të tyre dhe materialet përkatëse (duke përfshirë teknologjitë dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, në kundërshtim me legjislacionin vendas dhe detyrimet ndërkombëtare.”Përhapja gjithashtu përfshin blerjen, furnizimin dhe përdorimin e teknologjisë, mallrave, programeve kompjuterike, shërbimeve ose ekspertizës.*

“Financimi i përhapjes ADM” i referohet: aktit të ofrimit të fondeve ose shërbimeve financiare që përdoren, tërësisht ose pjesërisht, për prodhimin, blerjen, posedimin, zhvillimin, eksportin, transportimin, ndërmjetësimin, transferimin, grumbullimin ose përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjeteve të tyre të dorëzimit dhe materialeve të lidhura (duke përfshirë si teknologjitë ashtu edhe mallrat me përdorim të dyfishtë të përdorura për qëllime jo të ligjshme), në kundërshtim me ligjet kombëtare ose, kur është e aplikueshme, detyrimet ndërkombëtare.

Financimi i përhapjes së ADM mund të jetë:

- (a) financim i terrorizmit - kur ofron mbështetje financiare për organizatat terroriste që do të donin të blinin dhe/ose të përdornin një ADM; ose
- (b) financim nga një shtet, ose një entitet i kontrolluar nga shteti ose i sponsorizuar nga shteti, me qëllim që t'i ofrojë një shteti një ADM, ose për të përmirësuar apo zëvendësuar ato ekzistuese;

“Subjekte raportuese” – Subjektet e përcaktuara në nenin 3, të LPPP/FT

“Financimi i terrorizmit” Financimi i terrorizmit është akti i mbledhjes dhe ofrimit të fondeve, ose pasurive të tjera, për të mbështetur aktet terroriste, terroristët ose organizatat terroriste. Fondet mund të kenë burime të ligjshme, si fitimet ose donacionet e biznesit, ashtu edhe nga burime kriminale, siç janë trafikimi i drogës, rrëmbimi dhe mashtrimi.

“Sanksione të Shënjestruara Financiare - SSHF” Përfshijnë masat shtrënguese që synojnë të kenë një ndikim të kufizuar dhe strategjik ndaj individëve apo subjekteve, të shpallur, me qëllim ndërprerjen e financimit të terrorizmit dhe përhapjes së ADM. Termi nënkupton ngrirjen e fondeve dhe pasurive dhe parandalimin e vënies në dispozicion të fondeve ose burimeve të tjera ekonomike të tjera, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të individëve, subjekteve, grupeve ose ndërmarrjeve të shpallur. Sanksionet financiare kategorizohen në:

- a. Ngrirjen e Pasurive: Ngrirja është ndalimi i përkohshëm i çdo transferimi, konvertimi, disponimi, ndryshimi, përdorimi, trajtimi ose lëvizjeje të fondeve ose burimeve ekonomike që do të rezultonte në një ndryshim në vëllimin, shumën, vendndodhjen, pronësinë, posedimin, natyrën ose destinacionin e tyre ose që do të mundësonte në çfarëdo mënyre përdorimin për çfarëdo qëllimi të fondeve ose burimeve të tilla ekonomike nga individët apo subjektet e shpallura.
- b. Ndalimi i vënies në dispozicion të fondeve: Ndalimi i vënies në dispozicion të fondeve ose burimeve ekonomike ose ofrimit të shërbimeve financiare apo shërbimeve të tjera të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose bashkërisht, për ose në dobi të personit, grupit ose subjektit të shpallur.

“Pa vonesë” nënkupton, veprimet e menjëhershme dhe të shpejta që kërkohet nga vendet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të parandaluar zhvendosjen apo shpërndarjen e fondeve ose pasurive të lidhura me terroristët, organizatat terroriste ose përhapjen e ADM. Në praktikë keto veprime që lidhen me zbatimin efektiv të rezolutave të KSKB duhet të ndërmerren brenda pak orësh dhe shoqërohen me ngrirjen e shpejtë të fondeve dhe pasurive.

Përditësuar

Shtator 2025

Titulli	Versioni	Aprovuar në
Udhëzuesi i Sanksioneve Ndërkombëtare	1	Maj 2020
Udhëzuesi i Sanksioneve Ndërkombëtare	2	Prill 2022
Udhëzuesi i Sanksioneve Ndërkombëtare	3	Shtator 2025

HYRJJE

Çfarë janë SSHM

SSHM mund të vendosen në nivel ndërkombëtar (p.sh nga OKB) dhe më pas zbatohen nga të gjithë shtetet anëtare, në mënyrë të detyrueshme. Shtetet, gjithashtu mund të vendosin dhe zbatojnë SSHM në përputhje me politikat e tyre. SSHM vendosen dhe zbatohen bazuar në legjislacionin kombëtar, sipas detyrimeve të Rezolutave përkatëse të KSKB. SSHM në fuqi, zbatohen në mënyrë të detyrueshme për të gjithë personat dhe subjektet nën juridiksionin e shtetit të caktuar.

Llojet e SSHM

Sanksionet marrin forma të ndryshme dhe vendosen në përgjigje të situatave të caktuara. Llojet kryesore të SSHM janë:

1. Ngrirja e pasurive - e cila zakonisht zbatohet në rastin e individëve dhe subjekteve të shpallura si terroristë ose financues të terrorizmit, duke kufizuar qasjen e tyre në fonde dhe pasuri të tjera ose aftësinë e tyre për të përdorur burimet e tyre ekonomike.

Në rastet e ngrirjes së pasurive, individët, institucionet financiare, bizneset dhe subjektet raportuese nuk lejohen të:

- a. kryejnë transaksione ose të krijojnë marrëdhënie në të cilat përfshihen fonde ose burime ekonomike, që u përkasin, janë në pronësi ose kontrollohen nga persona të shpallur;
- b. ofrojnë fonde ose burime ekonomike, drejtpërdrejt ose tërthorazi, personave të shpallur;
- c. angazhohen në veprime që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, anashkalojnë kufizimet ose ndalimet e parashikuara në këto sanksione;

Fondet, burimet ekonomike dhe pasuritë e personave të shpallur duhet të ngrihen menjëherë nga personi ose subjekti që menaxhon ose kontrollon përdorimin e tyre.

2. Kufizime në shërbimet dhe transaksionet e ofruara nga tregjet dhe institucionet financiare - kufizime të tilla mund të zbatohen për grupe të caktuara ose sektorë të tërë të sistemit ekonomiko - financiar të një vendi. Këto kufizime përfshijnë individët dhe subjektet e shpallura dhe janë në formën e:

- a. ndalimit të investimeve;
- b. kufizimeve në tregjet e kapitalit;
- c. udhëzimeve për të ndërprerë marrëdhëniet dhe aktivitetet bankare;
- d. kërkesave për të kërkuar autorizim paraprak për marrëdhënie biznesi ose pagesa;

- e. kufizimeve në ofrimin e shërbimeve financiare, të sigurimeve, të ndërmjetësimit ose të konsulencës.

3. Udhëzime për të ndërprerë çdo marrëdhënie biznesi - të një natyre specifike me persona, grupe, territore ose vende specifike të caktuara.

SSHM në Lidhje me Terrorizmin dhe Financimin e Terrorizmit

Në vitin 1999, Kombet e Bashkuara (OKB) hartuan një Konventë Ndërkombëtare kundër Financimit të Terrorizmit, e cila është ratifikuar nga Shqipëria. Përveç kësaj konvente, KSKB ka miratuar rezoluta që synojnë bllokimin e qasjes së terroristëve dhe organizatat terroriste në fondet dhe pasuritë e tyre

Rezoluta 1267 (1999), i detyron juridiksionet të ngrijnë fondet dhe pasuritë e tjera financiare, ose burimet ekonomike në pronësi ose të kontrolluara nga persona ose organizata të lidhura me Al-Kaidën dhe Talibanët.

Rezoluta 1373, e miratuar në vitin 2001, i detyron të gjitha shtetet anëtare të ngrijnë fondet dhe pasuritë financiare ose burimet ekonomike të përdorura për të financuar terrorizmin.

Në vitin 2011, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutat 1988 (2011) dhe 1989 (2011). Me miratimin e këtyre rezolutave u krijuan dy komitete të veçanta sanksionesh, respektivisht për Al-Kaidën dhe Talibanët.

Në vitin 2015, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 2253 (2015) për të zgjeruar kriteret e listës për të përfshirë individë dhe subjekte që mbështesin të ashtuquajturin Shtet Islamik në Irak dhe Levant (ISIL ose Da'esh).

SSHM në Lidhje me Përhapjen e ADM

Regjimet e sanksioneve të vendosura nga KSKB-së, përfshijnë sanksione në lidhje me parandalimin, goditjen dhe ndërprerjen e përhapjes së ADM dhe financimin e tyre. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1718 (2006) dhe 1373 (2006) dhe pasardhëset e tyre përkatëse.

Këto rezoluta i detyrojnë vendet të zbatojnë SSHM, ndaj personave ose subjekteve të angazhuara ose që ofrojnë mbështetje për aktivitete dhe programe të ndjeshme ndaj përhapjes së ADM nga RPDK dhe Irani.

SSHM vendosen për të:

- a. Detyruar qeverinë e një vendi, ose individë të caktuar brenda atij vendi, të ndryshojnë sjelljen e tyre (ose aspekte të saj) duke rritur koston për ta në një masë të tillë, që ata të vendosin të ndërpresin sjelljen e tyre;

- b. Kufizuar një objektiv të caktuar, duke i mohuar atij qasje në burimet kryesore të nevojshme për të vazhduar sjelljen e tyre, duke përfshirë financimin e terrorizmit ose përhapjen e ADM;
- c. Sinjalizuar mosmiratimin dhe potencialisht izolimin e një qeverie ose individi në një vënd të caktuar, ose si një mënyrë për të dërguar mesazhe më të gjera politike në nivel kombëtar ose ndërkombëtar;

SSHF janë një lloj specifik i sanksioneve financiare me objektiva të deklaruar, njëri prej të cilave është parandalimi i financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së ADM.

Zbatimi i SSHF, përfshin si ngrirjen e pasurive ashtu edhe kufizimet dhe udhëzimet për të parandaluar që fondet ose pasuritë e tjera, duke përfshirë dhe ato virtuale, të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të personave dhe subjekteve të shpallur. Në krijimin e një regjimi efektiv kundër terrorizmit dhe financimit të përhapjes së ADM, merret në konsideratë edhe respektimi i të drejtave të njeriut, respektimi i sundimit të ligjit dhe njohja e të drejtave të palëve të treta të pafajshme.

SSHF përfshin përdorimin e instrumenteve dhe institucioneve financiare për të ushtruar presion mbi palë specifike, në një përpjekje për të ndryshuar ose kufizuar sjelljen e tyre. Sanksionet janë të shënjestruara në kuptimin që ato zbatohen vetëm për një nëngrup të popullsisë - zakonisht udhëheqja, elitat ose personat përgjegjës. Sanksionet janë financiare në kuptimin që ato përfshijnë përdorimin e instrumenteve financiare, të tilla si ngrirja e pasurive, bllokimi i transaksioneve financiare ose shërbimeve financiare. Ato janë sanksione në kuptimin, që përbëjnë masa shtrënguese të aplikuara për të bërë ndryshime.

Kur sanksioni financiar merr formën e një ngrirjeje të pasurive, ndalohet:

- a. Qasja në fondet ose pasurive e tjera, që i përkasin ose janë në pronësi, të mbajtura ose të kontrolluara nga një person ose entitet i shpallur;
- b. Vënia në dispozicion të fondeve ose pasurive të tjera, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ose në dobi të një personi ose entiteti të shpallur; ose
- c. Angazhimi në veprime që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, anashkalojnë ndalimet e sanksioneve financiare.

Bazuar në Nenin 41, të Kapitullit 7, të Kartës së OKB-së dhe me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, KSKB ka kompetencën për të ndërmarrë veprime duke vendosur masa sanksionesh që përfshijnë një gamë të gjerë opsionesh zbatimi, pa përdorimin e forcës së armatosur. Sanksionet e KSKB përqendrohen kryesisht në mbështetjen e zgjidhjes politike të konflikteve, parandalimin e përhapjes së armëve bërthamore dhe luftës kundër terrorizmit dhe përfshijnë masa që variojnë nga sanksionet gjithëpërfshirëse ekonomike dhe tregtare, deri në masa më specifike, siç janë embargot e armëve, ndalimet e udhëtimit dhe kufizimet financiare ose të mallrave.

KSKB, nëpërmjet Rezolutave të tij, mandaton zbatimin e masave të ngrirjes që lidhen, ndër të tjera, me:

- a. Terrorizmi dhe financimi i terrorizmit në përputhje me:
 1. Rezolutat e KSKB 1267 (1999), 1989 (2011) dhe rezolutat e tyre të mëvonshme përkatëse.
 2. Rezolutën 1988 (2011) dhe rezolutat e tyre të mëvonshme përkatëse.
 3. Rezolutën 1373 (2001).
- b. Financimi i përhapjes së ADM në me:
 1. Rezolutën KSKB 1718 (2006) dhe rezolutat pasardhëse të saj.
 2. Rezolutën KSKB 2231 (2015).

VENDOSJA E SSHM

Republika e Shqipërisë, si anëtare e OKB, është e angazhuar për vendosjen dhe zbatimin e Rezolutave të KSKB në lidhje me SSHM, duke përcaktuar procedurat rregullatore për zbatimin e masave të ngrirjes në përputhje me ligjet e mëposhtëme:

1. Ligji MKFT;
2. Ligji MSH;

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e sanksioneve në Shqipëri parashikohen në nenin 7, të MKFT dhe nenin 11 të Ligjit MSH.

Sanksionet, përfshirë ato financiare, në përgjithësi vendosen ndaj qeverisë së një vendi, individëve ose subjekteve të shpallur si terroristë ose financues të terrorizmit, ose atyre të përfshirë në përhapjen ose financimin e ADM. Sanksionet kanë si qëllim që të pengojnë qasjen që personat dhe subjektet kanë në burimet financiare dhe ekonomike, të cilat mund të përdoren për financimin e terrorizmit ose përhapjen e ADM.

DETYRIMET PËR ZBATIMIN E SSHM

Detyrime të Përgjithshme

Të gjithë personat, fizikë ose juridikë, në Shqipëri, duke përfshirë institucionet financiare dhe PBJF kanë detyrimet e mëposhtme:

- Ngrirjen e fondeve dhe burimeve ekonomike. **Ngrirja duhet të bëhet në mënyrë të menjëhershme, pa vonesë dhe pa njoftim paraprak të personave të shpallur;**
- **Ndalimi** i vënies në dispozicion të fondeve dhe/ose burimeve ekonomike;
- Njoftimi i AIF;


Përveç detyrimet të mësipërme, të gjitha subjektet raportuese kanë detyrimet e mëposhtme:

1. Informimin e vazhdueshëm dhe marrjen dijeni, në lidhje me ndryshimet dhe përditësimet e bëra në Listën e OKB-së dhe Listën Vendore të personave të shpallur;
2. Periodikisht, dhe në çdo rast menjëherë pas çdo ndryshimi në këto lista, subjektet kontrollojnë bazat e të dhënave të klientëve, pronarëve përfitues, marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve duke i krahasuar me listat e personave të shpallur në Listën e OKB-së dhe Listën Vendore;
3. Informojnë AIF, sapo konstatojnë ose dyshojnë se një klient i mëparshëm ose aktual, ose çdo person me të cilin ata kanë ose kanë pasur marrëdhënie në çfarëdo mënyre, ose çdo person që është përpjekur të kryejë transaksioneve apo marrëdhënie biznesi me ta, është një person i shpallur ose se fondet ose burimet financiare i nënshtrohen një vendimi ngrirjeje sipas pikës 4, të Nenit 10/1, të MKFT;
4. Informojnë AIF, mbi statusin e fondeve dhe burimeve ekonomike të personave të shpallur në këto lista, dhe çdo veprim të ndërmarrë në lidhje me të, natyrën dhe sasinë e fondeve ose burimeve ekonomike të ngrira, dhe çdo informacion tjetër përkatës;
5. Ngrijnë menjëherë pagesat e mëposhtme të bëra në ose nga një llogari të personit/ave të shpallur:
 - a. që duhen paguar sipas kontratave, marrëveshjeve ose detyrimeve që janë lidhur ose që kanë lindur para datës kur llogaria është ngrirë.
 - b. normat e interesit ose kthimin e fondeve që duhen paguar në llogari.
 - c. Informojnë AIF, për veprimet e ndërmarra sipas pikave ‘a’ dhe ‘b’.
6. Ndalojnë çdo njoftim ose informim të personit të shpallur ose personave të tjerë për zbatimin e masave të ngrirjes.
7. Miratojnë procedura të brendshme, kryejnë kontrolle dhe zbatojnë masa dhe sisteme administrimi të të dhënave të klientëve, për të siguruar që ato mundësojnë identifikimin e klientëve dhe pronarëve përfitues që i nënshtrohen SSHM.

Shpallja në Listën Vendore


Në përputhje me nenin 15 të ligjit MKFT, Ministri i Financave mund të shpallë, bazuar në kërkesën institucionale ose me kërkesë të një vëndi tjetër, një person në rast se ekziston dyshimi ose bindja, bazuar në arsye të arsyeshme, se i përmbush kriteret e përfshirjes në listën vendore. Shpallja duhet të bëhet pa vonesë dhe pa njoftim paraprak të personit që listohet.

Procesi i shpalljes në nivel vëndi kryhet në përputhje me Nenin 15 “Procedura e brendshme e shpalljes” të ligjit MKFT. Në vijim paraqiten në mënyrë skematike, hapat që ndërmerrën për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.



Shpallja në zbatim të rezolutave të KSKB

Procesi i shpalljes, në nivel zbatim të rezolutave të KSKB, kryhet në përputhje me Nenin 14 “Procedura e brendshme e shpalljes” të ligjit MKFT. Në vijim paraqiten në mënyrë skematike hapat që ndërmerrën për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.



Zbatimi i SSHM

Mosrespektimi i detyrimeve të listuara në ligjin MKFT, ekspozon çdo person fizik ose juridik, duke përfshirë subjektet raportuese (Institucionet Financiare dhe PBJF), ndaj masës administrative të mëposhtme:

Mosrespektimi nga organet dhe subjektet përgjegjëse i detyrimeve të parashikuara në këtë Ligj, kur nuk konsiderohet vepër penale, përbën shkelje administrative dhe sanksionohet me një gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 10 000 000 (10 milionë) lekë.

AIF është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit MKFT.

Mosrespektimi i detyrimeve të listuara në ligjin MSH ekspozon çdo person fizik ose juridik, duke përfshirë subjektet raportuese (Institucionet Financiare dhe PBJF), ndaj masave administrative të parashikuara në nenin 19, të ligjit:

Në rastet kur organi përgjegjës vlerëson se duhet të vendoset një gjobë për shkeljen e gjetur, subjektet gjobiten nga 50,000 (pesëdhjetë mijë) deri në 10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.

SSHM në Republikën e Shqipërisë:

Republika e Shqipërisë ka miratuar një legjislacion gjithëpërfshirës, për të zbatuar SSHM në përputhje me rezolutat e KSKB dhe rekomandimet ndërkombëtare.

Ky legjislacion përfshin një ligj specifik për fondet dhe pasuritë që lidhen me terrorizmin (MKFT) dhe një ligj të përgjithshëm mbi zbatimin e masave kufizuese ndërkombëtare, të zbatueshme për pasuritë që lidhen me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë (MSH).

Procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurisë së terroristëve ose personave të lidhur me terrorizmin, sipas Rezolutës 1267 të KS të OKB-së dhe Rezolutës 1373, përcaktohet në MKFT, si dhe në aktet nënligjore përkatëse.

MKFT, synon të parandalojë dhe të luftojë aktivitetet e terroristëve dhe atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, ose ata për të cilët ka dyshime të arsyeshme se kanë kryer, po kryejnë ose synojnë të kryejnë aktivitete të tilla, nëpërmjet ngrirjes, sekuestrimit të fondeve dhe pasurisë së tyre, në përputhje me rezolutat përkatëse të KSKB-së, aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare ose marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 22 “Sekuestrimi i fondeve dhe pasurive të tjera” i MKFT, përcakton modalitetet e sekuestrimit të fondeve dhe pasurisë. Kërkesa për ngrirjen e pasurisë bazohet në një urdhër sekuestrimi të Ministrit të Financave, për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për personat e shpallur në zbatim të rezolutave të KSKB.

Urdhri i Ministrit, ka efekte të menjëhershme dhe i komunikohet personit të shpallur në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

Urdhri i dërgohet njëkohësisht Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe institucioneve, organeve përgjegjëse apo subjekteve, të cilat në rastet kur identifikohen fonde dhe pasuri të tjera marrin masa për ekzekutimin e tij të menjëhershëm.

Sekuestrimi i fondeve dhe pasurive, zbatohet për të gjitha fondet dhe pasuritë e tjera, mbi të cilat personi i shpallur ushtron të drejta pronësie, kontrolli ose interesa të tjera, pavarësisht se kush i zotëron ose i përdor fondet ose pasuritë, si dhe për secilin fond dhe pasuri, në posedim ose të mbajtur nga persona të shpallur.

- a) në të cilën personi i shpallur ushtron të drejtat e kontrollit faktik;
- b) në pronësi ose të kontrolluara nga personi i shpallur, pa kufizuar masat mbi fondet dhe pasuritë e tjera që mund të shoqërohen me një akt, ose kërcënim specifik terrorist;
- c) të cilat kontrollohen individualisht ose bashkërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga persona të shpallur;
- ç) të siguruara apo të krijuara nga fondet ose pasuritë në pronësi ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga persona të shpallur;
- d) të personave që veprojnë në emër të ose nën drejtimin e personave të shpallur.

Blokim i përkohshëm i fondeve. Ministri i Financave, bazuar në Nenin 16 “Blokim i përkohshëm” të MKFT, mund të urdhërojë para nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, bllokimin e fondeve dhe pasurive të tjera për një periudhë prej 45 ditësh.

Detyrimet për Individët dhe subjektet raportuese pas njoftimit të shpalljes

Neni 10/1 “Ngrirja e përkohshme” e MKFT, përcakton detyrimin për subjektet raportuese të LPPP/FT dhe çdo subjekt ose individ tjetër në Republikën e Shqipërisë, që të ngrijnë përkohësisht fondet ose pasuritë e tjera të subjekteve ose individëve të shpallur nga KSKB ose çdo organizatë tjetër ndërkombëtare, menjëherë pas njoftimit.

Vendimet e KSKB ose të organizatave të tjera ndërkombëtare ju njoftohen në rrugë elektronike subjekteve raportuese të regjistruara në modulën e raportimit të AIF dhe gjithashtu publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të institucionit (www.fiu.gov.al).

Në përputhje me Nenin 10/1, ndalohet dhënia e njoftimit paraprak për ngrirjen e përkohshme çdo personi të shpallur, të interesuar ose të përfshirë në këtë proces. Vendimet e KSKB konsiderohen të njoftuara zyrtarisht nga momenti që AIF ka publikuar njoftimin në faqen zyrtare të internetit.

Ngrirja e përkohshme sipas nenit 10/1 të Ligjit MKFT, ndalon transferimin, konvertimin, disponimin ose lëvizjen e çdo fondi ose prone tjetër në pronësi ose të kontrolluar nga një person ose entitet i shpallur dhe përfshin fonde ose pasuri të tjera, burime ekonomike, financiare ose shërbime të tjera. Është e ndaluar, që këto fonde apo pasuri të vendosen në mënyre të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dispozicion të personave ose entiteteve të shpallur, subjekteve në pronësi ose të kontrolluara drejtpërdrejt ose të kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi prej tyre dhe personave ose entiteteve që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e personave ose subjekteve të shpallur.

Ngrirja e përkohshme zbatohet drejtpërdrejt nga subjektet raportuese ose çdo person, menjëherë, pa pasur nevojë për një urdhër ngrirjeje, ose një vendim përkatës të Këshillit të Ministrave sipas nenit 18 të MKFT dhe mbetet në fuqi derisa të miratohet një urdhër bllokimi sipas nenit 16 të MKFT. Shpalljet nga KSKB, kanë një efekt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në Shqipëri.

Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë

Procesi i ngrirjes së fondeve dhe pasurive të personave të shpallur sipas Rezolutave 1718 dhe 1737, të KSKB është e përcaktuar në Ligjin MSH dhe aktet nënligjore përkatëse. Qëllimi i këtij ligji, është të krijojë dhe zbatojë masa shtrënguese, që shërbejnë për të ruajtur paqen dhe sigurinë, për të parandaluar konfliktet ndërkombëtare, për të mbështetur dhe forcuar demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, si dhe për të arritur objektiva të tjera të përbashkëta të sigurisë në përputhje me rezolutat përkatëse të KSKB, aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare ose traktatet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Kjo përfshin masat ndërkombëtare të lartpërmendura për të luftuar përhapjen ADM.

Neni 6 “Masa për fondet dhe pasuritë e tjera”, i Ligjit MSH, përcakton modalitetet e sekuestrimit të fondeve dhe pasurive të tjera. Këshilli i Ministrave, miraton zbatimin e masave shtrënguese

ndërkombëtare (të cilat përfshijnë shpalljet sipas Rezolutave 1718 dhe 1737 të KSKB) me rekomandimin e Ministrit përgjegjës për Punët e Jashtme.


Ngrirja e fondeve sipas ligjit MSH, nënkupton ndalimin e transferimit, ndryshimit, posedimit ose zhvendosjes së:

- a) çdo fondi dhe prone në pronësi ose të kontrolluar nga personat ose subjektet e shpallur dhe jo vetëm ato që mund të shoqërohen me një akt, plan ose kërcënim të veçantë për financimin e prodhimit të ADM;
- b) çdo fondi ose pasuri tjetër në pronësi të plotë, të mbajtur bashkërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi të kontrolluar nga personat ose subjektet e shpallur;
- c) fondeve ose pasurive, të siguruara apo të krijuara nga fondet ose pasuritë në pronësi ose të kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personat ose subjektet e shpallur;
- ç) fondeve dhe pasurive, të personave ose subjekteve që veprojnë në emër ose nën drejtimin e personave ose subjekteve të shpallur;

Neni 12 “Ngrirja e pronës dhe fondeve” të Ligjit MSH, përmban detyrime të qarta në lidhje me llogaritë e ngrira sipas Rezolutave 1718 dhe 1737 të KSKB, të cilat lejojnë grumbullimin e interesit mbi ato llogari, si dhe pagesat sipas kontratave të mëparshme ose detyrimeve të tjera, me kusht që interesi, të ardhurat ose pagesa e tillë të jetë e ngrirë. Për më tepër, për fondet dhe pasuritë e ngrira sipas Rezolutës 1737 të KSKB, një person ose subjekt i shpallur mund të bëjë pagesa bazuar në një kontratë të mëparshme, me kusht që kontrata të mos ketë të bëjë me asgjë të ndaluar sipas Rezolutës 1737, pagesa të mos bëhet drejtpërdrejt ose tërthorazi ndaj një personi ose subjekti të shpallur dhe njoftimi t'i jetë dhënë komitetit përkatës të KSKB.

Procesi i shpalljes sipas ligjit MSH

Në vijim paraqitet në mënyrë skematike procesi i shpalljes së personave apo subjekteve sipas ligjit MSH.



Detyrime për subjektet raportuese

Ndalimi i përkohshëm i aktiviteteve që lidhen me një person të shpallur, përcaktohet në Nenin 8 të Ligjit MSH dhe nënkupton ndalimin e çdo transaksioni, shërbimi financiar ose shërbimi tjetër të lidhur, pjesëmarrjen në transferimin, transformimin, ndryshimin ose lëvizjen e fondeve ose pasurive të tjera që përfshin pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, në varësi të kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë, në zbatim të veprimeve të ndërmarra nga institucionet kompetente.

Bazuar në njoftimin nga Ministri përgjegjës për Punët e Jashtme, në lidhje me çdo ndryshim në listën e personave të shpallur, të gjithë personat juridikë ose fizikë në Republikën e Shqipërisë janë:

- **Të detyruar të pezullojnë menjëherë** çdo veprim, ndërmjetësim, transaksion, transferim, shërbime financiare ose të tjera të lidhura, fonde dhe mjete të tjera, pa pasur nevojë për akte nënligjore shtesë.
- **Kjo vlen për çdo rast** kur subjekti i shpallur, ushtron të drejta pronësie ose kontrolli, me autorizim, ose të drejta dhe interesa të tjera, pavarësisht se kush i zotëron ose posedon fondet ose pronën, si dhe çdo fond ose pronë të mbajtur ose në posedim të personit të shpallur.
- Fondet dhe pronat e bllokuara përkohësisht, mbeten në pronësi të personave që kanë të drejta pronësie mbi to, në momentin e vendosjes së masës së bllokimit.

Bazuar në pikën 5, të nenit 8 “Bllokimi i përkohshëm” të ligjit për MSH, vendimi për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive është i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm dhe është i vlefshëm për një afat 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas miratimit të tij. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 8, ndalohet njoftimi paraprak i personave të shpallur, të interesuar ose të prekur, në lidhje me masat për bllokim të përkohshëm.

Bazuar në legjislacionin aktual, shpalljet që lidhen me përhapjen e ADM nga KSKB, kanë një efekt të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në Shqipëri.

Detyrimet e raportimit: Çfarë duhet të raportoni në AIF

Sipas Nenit 10 “Detyrimet e raportimit” të MKFT, ekzistojnë dy detyrime raportimi. Së pari, pika 1, e këtij neni zbatohet për subjektet raportuese të ligjit LPPP/FT, të cilët duhet të raportojnë në AIF informacionin ose dyshimet për veprime financiare, transaksione, fonde ose akte të tjera, të kryera ose të tentuara për t’u kryer, që synojnë të kryejnë ose financojnë akte terroriste, pavarësisht nga vlera e tyre.

Së dyti, detyrimi sipas pikës 2, të Nenit 10, zbatohet për çdo person në Republikën e Shqipërisë që ka dijeni për operacionet financiare, transaksionet, fondet ose akte të tjera të kryera ose të tentuara për t'u kryer, me qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste, të cilët kanë detyrimin të njoftojnë menjëherë AIF.

Përveç detyrimeve të raportimit sipas Nenit 10, të dhënat e plota mbi rastet e ngrirjes së përkohshme sipas Nenit 10/1 “Ngrirja e Përkohshme”, duke përfshirë transaksionet në tentativë, duhet t'i komunikohen menjëherë AIF, e cila jep udhëzimet e nevojshme.

Në çdo rast, raportimi duhet të kryhet menjëherë dhe pa njoftim paraprak ose përfshirje të të dyshuarve dhe personave të prekur. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi identifikimin e fondeve dhe pasurive të tjera, pronësinë dhe interesat e tjera të lidhura, si dhe një shpjegim të bazuar të motiveve dhe dokumenteve mbështetëse. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet detyrimi për të raportuar transaksionet në tentativë, duke përfshirë rastet kur transaksioni nuk kryhet, qoftë për shkak se subjekti raportues ka refuzuar të krijojë marrëdhënien e biznesit, klienti vendos të mos e kryejë atë ose për arsye të tjera.

Leja për qasje në fondet dhe pasuritë e ngrira

Bazuar në Nenin 23 “Shpenzime të lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera” të MKFT, Ministri përgjegjës për financat, mund të autorizojë pagesat nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara që do të përdoren për nevojat mjekësore, familjare dhe personale të personit të shpallur, për pagesën e detyrimeve shtetërore ose që lidhen me punën dhe sigurimin e detyrueshëm. Vendimi i Ministrit për refuzimin për të autorizuar pagesën, mund të apelohe në gjykatën kompetente brenda një afati 5 ditor.

Në përputhje me nenin e sipërpërmëndur, Ministri përgjegjës për financat ka miratuar Udhëzimin nr. 1 datë 16.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të deklaruar”, në të cilin përcaktohen të drejtat dhe shpenzimet që personat e shpallur kanë për fondet dhe pasuritë e sekuestruara.

Kategorizimi i shpenzimeve të lejuara, bazohet në Rezolutën 1452 të KSKB dhe synon të krijojë kushtet për mbulimin e shpenzimeve për ushqim, barna dhe trajtim mjekësor, pagesën e qerasë ose hipotekës, si dhe detyrime të tjera të shkaktuara nga një forcë madhore.

Neni 4, i këtij udhëzimi përcakton kërkesën që paditësi duhet t'i paraqesë Ministrit të Financave, të shoqëruar me pretendimet e tij në lidhje me fondet e sekuestruara, si dhe të dhëna në lidhje me shumën dhe qëllimin e përdorimit të këtyre fondeve. Kërkesa, shqyrtohet në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

Në rastet që lidhen me financimin e përhapjes së ADM, qasja në fonde dhe pasuri të tjera parashikohet në nenin 13 “Lejimi i përdorimit të aseteve të bllokuara” të Ligjit për MSH. Vendimi për qasjen në fonde mund të jepet nga një gjykatë kompetente, me kusht që të provohet se fondet janë të nevojshme për:

- a) mbulimin e shpenzimeve bazë të jetesës, qerasë ose hipotekës, barnave ose trajtimit mjekësor, taksave dhe sigurimeve ose kostove që lidhen me shërbimet publike;
- b) pagesën vetëm të taksave për mirëmbajtjen e rregullt të pasurive të ngrira;
- c) shpenzime të jashtëzakonshme, të tilla si shpenzimet që lidhen me lindjen e fëmijëve, vdekjen në familje ose situata të ngjashme;

FONDE DHE PASURITË QË I NËNSHTROHEN NGRIRJES

Rezolutat 1267, 1373, 1718 dhe 1737 të KSKB dhe kërkesat e Rekomandimeve 6 dhe 7 të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF), përmbajnë detyrimin për ngrirjen e fondeve ose pasurive të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- pasuri financiare;
- burime ekonomike;
- pasuri të çdo lloji të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e blerjes dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo forme (elektronike ose dixhitale);
- letra me vlerë, ose interesat që rrjedhin prej tyre;
- kreditë bankare;
- çeqe të udhëtarit;
- çeqe bankare;
- urdhërpagesa;
- aksione;
- sigurime;
- obligacione dhe bono thesari dhe çdo interes i përfshirë prej tyre;
- fitimet e kompanive.

Në përputhje me rekomandimet e FATF, Neni 3 i ligjit, MKFT përmban përkufizimin në vijim për fondet dhe pasuritë e tjera.

“Fonde dhe pasuri të tjera” janë pasuritë e çdo lloji, të përfshira, por pa u kufizuar në ato

financiare, depozitat monetare, burimet ekonomike dhe pasuritë e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo

interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.”

Ligjit për MSH përmban gjithashtu jep një përkufizim të qartë të fondeve dhe pasurisë në nenet 4.1 dhe 4.13.

4.1. "Pasuri" janë fondet dhe të gjitha elementët e tjerë të pronave të shteteve, organizatave ndërkombëtare, personave fizikë dhe juridikë dhe subjekteve të tjera ndaj të cilave zbatohen masa kufizuese, duke përfshirë: asetet likuide, çekët, kërkesat financiare, kambialet, paratë elektronike dhe mjete të tjera pagese; instrumente financiare, të përmendura në ligjin që rregullon tregjet financiare, duke përfshirë aksionet, obligacionet, garancitë dhe instrumente të tjera financiare, që vërtetojnë të drejtat mbi fondet ose burimet e tjera financiare, si dhe çdo objekt ose e drejtë ekonomike:

a) të kontrolluara, tërësisht në pronësi, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga subjektet e lartpërmendura;

b) të nxjerra dhe të gjeneruara nga asetet e zotëruara ose të kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga subjektet e lartpërmendura;

c) të personave ose subjekteve që veprojnë në emër të ose nën drejtimin e subjekteve të lartpërmendura.

"Fondet" janë asete të çdo lloji, pavarësisht nëse përfshihen apo jo, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e blerjes, si dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo forme, duke përfshirë letrat me vlerë elektronike ose dixhitale ose interesat në këto asete.

PËRPUTHSHMËRIA DHE MBIKËQYRJA

Një nga detyrat funksionale të AIF, është mbikëqyrja e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve të ligjit me legjislacionin MKFT dhe MSH. Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me subjektet, aktiviteti institucional i AIF përqendrohet në:

- a) ofrimin e mbështetjes për subjektet e ligjit, në lidhje me identifikimin dhe ngrirjen e fondeve ose pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpallur;
- b) parandalimin e kryerjes së transaksioneve nga personat dhe subjektet e shpallur, nëpërmjet sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë;
- c) përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit dhe procedurave të brendshme, duke zbatuar rekomandimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- ç) trajnimin e vazhdueshëm, publikimin e treguesve dhe tipologjive;

Niveli i përputhshmërisë mbikëqyrës në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet inspektimeve, si dhe bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të subjekteve përkatëse raportuese. Neni 21 “Verifikimi i identitetit, fondeve dhe pasurive të tjera” të MKFT, përcakton gjithashtu proceset, që ju mundëson institucioneve mbikëqyrëse të marrin nga subjektet raportuese, informacion në lidhje me fondet dhe pasuritë që lidhen me personat e shpallur dhe ta dërgojnë këtë informacion në AIF.

MASAT PARANDALUESE DHE KOMUNIKIMI

Si ta përdorni këtë udhëzues

Masat e ndërmarra nga subjektet e ligjit që zbatojnë legjislacionin për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit kanë një rol parësor në nivelin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga sanksionet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Në këtë drejtim, procedurat e brendshme për identifikimin dhe verifikimin e klientëve, mbajtjen e të dhënave, vlerësimin e rrezikut dhe kategorizimin e klientëve për këtë qëllim, emërimin dhe funksionimin e një personi ose njësisë përgjegjëse për përmbushjen, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit luajnë një rol të veçantë.

Për rritjen e efektivitetit të sistemit ndërkombëtar të parandalimit dhe zbatimin rigoroz të sanksioneve, subjektet, dhe veçanërisht institucionet financiare dhe PBJF, janë të detyruara ta përdorin këtë udhëzues në të ardhmen:

- a) të zbatojnë masa rigoroze në marrëdhëniet e tyre të biznesit me vendet ose subjektet që konsiderohen me rrezik të lartë në nivel ndërkombëtar;
- b) të rishikojnë rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme drejt kontrollit efektiv të listës së personave të shpallur dhe ngrirjes së menjëhershme të fondeve ose pasurive të tjera;
- c) për programet e trajnimit të vazhdueshëm që u ofrohen punonjësve të tyre. Përmes një trajnimi të tillë, subjektet duhet të synojnë rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të drejtuesve, menaxherëve dhe punonjësve për rolet e tyre specifike në parandalimin e financimit të terrorizmit;
- ç) të shqyrtojnë vlerësimin e riskut të klientëve të tyre dhe në bazë të përfundimeve të tyre, të përdorin treguesit e financimit të terrorizmit dhe ADM, siç parashikohet në shtojcën 1 të këtij udhëzimi;
- d) të mbajnë kontakte të vazhdueshme me AIF, për të kërkuar ndihmën e nevojshme për raste të ngjashme, si dhe për raportimin sipas detyrimeve ligjore;
- e) të japin kontribute specifike në vlerësimin kombëtar të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- ë) të vlerësojnë paraprakisht nivelin e riskut të produkteve ose shërbimeve të reja;

Bazuar në madhësinë dhe kompleksitetin e shërbimeve që ofrohen nga subjektet, është thelbësore që vlerësimi i riskut individual të marrë në konsideratë çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e importit/eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mjetet e financimit të tyre, produktet ose shërbimet që mund të lidhen me llojet e njohura të financimit të terrorizmit, ose industritë që lidhen me ADM. Subjektet duhet të sigurojnë dhe procesin e monitorimit të vazhdueshëm të llogarive, ose marrëdhënieve të biznesit të kategorizuara si rrezik i lartë, raportimin në kohë dhe ngrirjen e fondeve dhe pasurive të personave të shpallur.

Për të siguruar zbatimin efektiv të detyrimeve të ngrirjes së fondeve dhe pasurive të personave të shpallur, AIF i kushton vëmendje të veçantë komunikimit me sektorin privat, i cili ka një rol parësor në zbatimin efektiv të rezolutave përkatëse të KSKB.

Ky komunikim ndër të tjera synon të sigurojë publikimin dhe shpërndarjen në kohë dhe në shkallë të gjerë të informacionit të mëposhtëm tek subjektet:

- a) kufizimet e zbatueshme për ngrirjen e fondeve apo pasurive dhe detyrimet përkatëse për sektorin privat brenda vendit për të identifikuar, ngrirë dhe siguruar që fondet dhe pasuritë të mos vihen në dispozicion të personave që janë shpallur ose janë në proces të shpalljes;
- b) detyrimet për raportim të menjëhershëm në AIF mbi fondet dhe pasuritë e tjera të lidhura me to, për të siguruar ngrirjen e tyre pa vonësë;
- c) veprimet e ndërmarra sipas mekanizmit të ngrirjes së pasurive;
- ç) legjislacioni dhe procedurat e përditësuara në lidhje me mekanizmin për shpalljen e personave dhe ngrirjen e fondeve ose pasurive të tjera;

Informacioni sipas paragrafit 'a' mbi identifikimin e të gjithë personave dhe subjekteve që i nënshtrohen mekanizmit të ngrirjes së pasurive sipas rezolutave të KSKB, ofrohet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të internetit të AIF të një liste të plotë dhe të përditësuar të të gjithë personave dhe subjekteve të shpallur.

Informacione të mëtejshme për qëllime të zbatimit të këtij udhëzuesi dhe përditësimet që bëhen në listën e personave të shpallur, mund të merren duke kontaktuar AIF në adresën inspektim@fint.gov.al.

Cilësia dhe dobia e të dhënave

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të transaksioneve të mbuluara nga ngrirja e fondeve ose pasurive, si dhe numrin e konsiderueshëm të personave dhe subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, është e rëndësishme që sektori privat të sigurojë një nivel të lartë të përputhshmërisë me detyrimet ligjore në fuqi.

Për të siguruar një nivel të përshtatshëm të zbatimit të sanksioneve, AIF përditëson dhe publikon vazhdimisht në faqen e internetit, listën e personave të shpallur bazuar në rezolutat e KSKB, për të siguruar një informim sa më të gjërë të subjekteve dhe publikut në përgjithësi.

Procesi i apelimit: apelimi i një shpallje ose heqja e sanksioneve
Mbrotjtja e të drejtave të njeriut është një pjesë integrale e çdo sistemi për ngrirjen e fondeve dhe pasurive të tjera të personave të shpallur, përfshirë ato që lidhen me ta.

Në këtë kontekst, si MKFT ashtu edhe Ligji për MSH përfshijnë dispozita apelimi.

Neni 17 i MKFT, “Apelimi kundër bllokimit të përkohshëm” dhe Neni 19 i tij, “Apelimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave”, kanë parashikuar një mekanizëm të qartë për apelimin e urdhrin të bllokimit të përkohshëm të Ministrit të Financave dhe listimin e personit të shpallur, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rast apelimi kundër ngrirjes së përkohshme, personi i interesuar është i detyruar të provojë para gjykatës se ai:

- a) ka një të drejtë legjitime në fondet dhe pasuritë e tjera të personave, të përfshira në urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- b) ka burime ligjore për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera;
- c) fondet dhe pasuritë e tjera që i nënshtrohen gjykimit nuk janë të lidhura me terroristë, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur.

Në rastet e ankimeve kundër vendimeve të Këshillit të Ministrave, kjo vlen për vendimet e marra për të zbatuar si kornizat e Rezolutës 1267 të KSKB ashtu edhe Rezolutën 1373 (për shpalljet brënda vendit). Lidhur me shpalljet sipas Rezolutës 1267 të KSKB, ankimi mund të bëhet vetëm në rast se personi që paraqet ankim është identifikuar gabimisht, me personin e shpallur.

Neni 24 “Ankimi ndaj urdhrin të sekuestrimit” i MKFT, mundëson të drejtën e ankimit kundër urdhrin të sekuestrimit në rastet kur personat e shpallur dhe personat përkatës pretendojnë se janë me mirëbesim. Ankimi bëhet në gjykatën kompetente, në përputhje me afatet dhe procedurat e procedurave administrative.

Neni 18 “E drejta për ankim” i Ligjit për MSH përmban gjithashtu dispozita që lejojnë që ankimi të paraqitet nga një person apo subjekt që pretendon se është identifikuar gabimisht si person i shpallur.

PROCESI I HEQJES NGA LISTA

Kërkesë për heqje nga Lista Vendore

Neni 25 “Ndryshimet dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur” i MKFT përcakton procesin e heqjes nga lista e personave të shpallur, që ndodh në njërin nga rastet e mëposhtme:

- a) ka një vendim të mëvonshëm të strukturave të KSKB, sipas paragrafit 1 të nenit 5 të ligjit;
- b) për shkak të një detyrimi të kërkuar nga, ose që rrjedh për Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së OKB-së;
- c) vendimit përkatës të organizatave të tjera ndërkombëtare, Bashkimit Evropian, ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;
- ç) një vendim heqjeje nga lista nga vendi që ka aplikuar për përcaktimin e personit përkatës;
- d) ka një vendim përfundimtar nga një gjykatë kompetente, bazuar në ankimin e personit të përcaktuar, në përputhje me paragrafët 1 dhe 3, të nenit 19 të këtij ligji;
- e) për shkak të ndryshimeve në rrethana, fakte dhe arsyetim që mbështesin përcaktimin, sipas nenit 15 të këtij ligji;

Lidhur me financimin e përhapjes së ADM, vendimet e Këshillit të Ministrave për të zbatuar dispozitat e organeve ndërkombëtare mund të revokohen në përputhje me nenet 6 dhe 7, të Ligjit për MSH.

Personat që kërkojnë të paraqesin kërkesë për heqjen nga listat e personave të shpallur, për informacion të mëtejshëm i referohen faqes së mëposhtme të Organizatës së Kobmeve të Bashkuara.

<https://main.un.org/securitycouncil/en/sanctions/delisting/delisting-requests>

RAPORTIMI NË AIF

1. Kur një subjekt raportues identifikon një përputhje të konfirmuar ose të mundshme të emrit të klientit (ose personave të lidhur) me atë të një personi të shpallur, është i detyruar të raportojë në AIF për masat e ngrirjes, brenda 24 orëve.
2. Raportimi i çdo mase ngrirjeje ose transaksioni në tentativë nga një individ, subjekt ose grup i caktuar duhet t'i komunikohet direkt AIF-s nëpërmjet email-it (info@fint.gov.al) brenda 24 orëve nga zbatimi i çdo mase ngrirjeje.

Çfarë duhet të raportohet

1. Kur kontaktohet AIF për shkak të një mase ngrirjeje që po zbatohet, subjektet raportuese janë të detyruara të përfshijnë në komunikimin informacionin e mëposhtëm:
 - a. Emri i plotë i përputhjes së konfirmuar ose të mundshme të personit ose subjektit të shpallur;
 - b. Dokumentet e identifikimit të përputhjes së konfirmuar ose të mundshme;

- c. Lloji i fondeve dhe/ose pasurive të ngrira;
- d. Vlera e fondeve dhe/ose pasurive të ngrira (e ndarë sipas llojit të fondeve dhe/ose aseteve të ngrira);

Subjektet raportuese janë të detyruara të ngrijnë fondet ose pronën e një personi ose subjekti të listuar në përputhje me ligjin MKFT. Ngrirja pa vonesë e fondeve ose pronave të tilla është e nevojshme për të parandaluar devijimin e çdo fondi ose prone që lidhet me terroristët, organizatat terroriste, ata që financojnë terrorizmin dhe me financimin e përhapjes së ADM, si dhe nevojën për veprime të përbashkëta globale për të ndaluar dhe ndërprerë rrjedhën e tyre.

Kontrolli i ndërmarrë nga subjektet

Për të ngrirë në mënyrë efektive pa vonesë fondet dhe pasuritë e tjera të personave të shpallur, Subjektet Raportuese duhet të kryejnë shqyrtimin e klientëve dhe pronarëve të tyre përfitues dhe të verifikojnë klientët e tyre kundrejt listave të mëposhtme:

1. Lista e Konsoliduar e subjekteve të personave të shpallur, e miratuar në përputhje me Rezolutat e KSKB;
2. Lista vendore a personave të shpallur;

Ky proces përfshin shqyrtimin e emrave të personave dhe subjekteve të caktuar kundrejt listës së klientëve të subjektit raportues.

Shqyrtimi nga subjekti raportues, duhet të kryhet:

Në fazën e vendosjes së një marrëdhënie biznesi ose kryerjes së një transaksioni të vetëm për një klient, për tu siguruar që klienti nuk është person i shpallur ose nuk po kryen transaksione me këta persona;

Menjëherë dhe pa vonesë pas marrjes së njoftimit nga AIF, për përditësimin e listës së personave të shpallur. Pas marrjes së këtij njoftimi, subjekti raportues duhet të marrë masa për të siguruar që asnjë nga klientët e tij nuk është person i shpallur dhe se nuk zotëron fonde ose pasuri të tjera që i përkasin një personi të shpallur.

Nëse ky shqyrtim rezulton në një përputhje (qoftë dhe e pjesshme e të dhënave), nga subjekti raportues, duhet të ndërmerren veprimet e mëposhtme.

1. Pas shqyrtimit të listave të lartpërmendura të personave të shpallur, nëse personi apo subjekti konkludon se disponon dhe administron fonde apo pasuri për një person të shpallur, duhet të ndërmarrë menjëherë dhe pa vonesë veprimet e mëposhtme:

- Të informojë menjëherë AIF nëse ka fonde që i përkasin një personi të shpallur;
 - Të paraqesë një raport me shkrim në AIF, i cili përmban të dhënat e plota për rastet e ngrirjes së përkohshme, përfshirë dhe transaksionet e mbetura në tentativë, në përputhje me pikën të nenit 10/1, të ligjit MKFT;
2. Nëse një person apo subjekt i shpallur, përpiket të hyjë në një transaksion ose të vazhdojë marrëdhëniet e biznesit, subjekti nuk duhet ta kryejë transaksionin ose të vendosë marrëdhënien si dhe të ndërpresë marrëdhënien e biznesit, që ka filluar më parë.

Ngrirje e përkohshme

Subjekti raportues (dhe çdo person) duhet të ndërmarrë veprimet e mëposhtme në përputhje me ngrirjen e fondeve ose pronës së personit ose subjektit të caktuar menjëherë dhe pa vonesë.

1. Nëse subjekti raportues (dhe çdo person) ka fonde ose pasuri që i përkasin një personi të shpallur, duhet që nëpërmjet ngrirjes së përkohshme të ndërpresë çdo transaksion apo shërbim që lidhet me to. Ngrirja e përkohshme zbatohet për:
 - të gjitha fondet ose pasuritë që janë në pronësi ose të kontrolluara plotësisht apo pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personi i shpallur;
 - fondet ose pasuritë që rrjedhin ose sigurohen nga fondet ose pasuritë e kontrolluara drejtpërdrejt ose tërthorazi nga personat e shpallur;
 - fondet ose pasuritë e personave që veprojnë në emër të, ose sipas udhëzimeve të personave të shpallur.
2. Subjekteve raportuese (dhe çdo person) ju ndalohet të vënë në dispozicion fonde, pasuri por të ofrojnë shërbim financiar ose të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose bashkërisht në dobi të:
 - a. personave të shpallur;
 - b. subjekteve në pronësi ose të kontrolluara, drejtpërdrejt ose tërthorazi nga persona të shpallur.
 - c. personave dhe subjekteve që veprojnë në emër të, ose sipas udhëzimeve të personave të shpallur;

Në asnjë rrethanë një subjekt raportues nuk duhet të hyjë në ose të vazhdojë një marrëdhënie biznesi

LIDHJE TË RËNDËSISHME

Në vijim paraqiten disa nga faqet e internetit me të dhënat e rezolutave dhe udhëzues për çështjet e financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

Në adresën e mëposhtëme subjektet mund të sigurojnë informacion të përditësuar mbi listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB për rezolutën 1267 (dhe rezolutat pasardhëse). Faqja mundëson edhe regjistrimin për të marrë informacion për përditësimet që i bëhen listës.

<https://www.un.org/securitycouncil/sanctions/un-sc-consolidated-list>

Në faqen zyrtare të AIF publikohen VKM për personat e shpallur mbi bazën e rezolutave 1267 dhe 1373.

www.fiu.gov.al

Në faqen e FATF publikohen rekomandimet ndërkombëtare dhe udhëzues në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

<http://www.fatf-gafi.org/>

Në faqen e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës, publikohen raportet e vendeve anëtare, përfshirë dhe Shqipërinë, në të cilët pasqyrohet niveli i përputhshmërisë me rekomandimet ndërkombëtare të FATF.

<https://www.coe.int/en/web/moneyval>.

Shtojca 1. Treguesit e financimit të terrorizmit dhe ADM.

Në vijim paraqiten një sërë treguesish që subjektet e ligjit mund të përdorin në funksion të monitorimit të vazhdueshëm të nivelit të përputhshmërisë së tyre me detyrimet për parandalimin e financimit të terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë.

- Klienti është i përfshirë në furnizimin, shitblerjen e mallrave me përdorim të dyfishtë;
- Adresa e klientit ose personave të lidhur në marrëdhënie biznesi me të është e njëjtë me atë të personave ose subjekteve të përfshirë në listën e sanksioneve ndërkombëtare;
- Klienti është një ushtarak ose institucion kërkimor që është i lidhur me vende me rrezik për financimin e armëve të shkatërrimit në masë;
- Aktiviteti i klientit nuk përputhet me profilin e biznesit;
- Klienti jep përgjigje konfuze në lidhje me palët në transaksione ose marrëdhënie biznesi dhe paraqet rezistencë kur i kërkohet të japë informacion shtesë;
- Klienti përdor struktura komplekse (një seri letrash krediti, kompani guackë, ndërmjetësues ose komisioner nga vende me rrezik, instrumente financiare të panjohura për vëndin në të cilin zhvillon aktivitetin, financimi i projektit përmes kredive komplekse, etj);
- Transaksione që lidhen me mallra me përdorim të dyfishtë veçanërisht nga vende me rrezik;
- Transaksione që përfshijnë persona ose subjekte nga vende me rrezik për armët e shkatërrimit në masë;
- Transaksione që tregojnë se ka një lidhje mes perfaqësuesve të kompanive (p.sh. të njëjtët pronarë ose administratorë) që shkëmbejnë mallra, në mënyrë që të shmangin kontrollin e mëtejshme;
- Transaksione në lidhje me mallra që nuk përputhen me shkëmbimet normale tregëtare mes vendeve;
- Porositë për mallra bëhen nga kompani ose individë nga vende të ndryshme nga ai i përdoruesit final;
- Marrëdhënie biznesi me institucione në vende, me nivel të ulët në zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare apo me mekanizma të dobët të kontrollit mbi importet dhe eksportet;
- Të dhëna të paqarta mbi destinacionin përfundimtar të mallrave me përdorim të dyfishtë apo përdoruesin final;
- Përdorimi i çertifikatave të manipuluar për eksportin e mallrave apo përdorimin e tyre final;
- Përdorimi i kompanive të speditimit si adresë finale për destinacionin e mallrave;
- Udhëzime për transfertat ose pagesat për persona që nuk janë të përfshirë në dokumentacionin origjinal;
- Transferta komplekse të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm nga pikëpamja ekonomike;
- Mospërputhje në informacionin e marrëdhënies së biznesit apo transaksioneve (psh emrat, kompanitë dhe adresat e tyre, destinacioni final);
- Përfshirja e një personi që lidhet me vendet me rrezik;

- Marrëdhënie biznesi për mallra apo pajisje komplekse për të cilat klienti nuk ka eksperiencën përkatëse;
- Përdorimi i pagesave me para në dorë ose metale të çmuara (p.sh ar) në transaksione për produkte industriale;
- Palët në transaksion (pronari, përfituesi, etj.) janë nga vende të njohura për mbështetje të aktiviteteve dhe organizatave terroriste;
- Media raporton se mbajtësi i llogarisë është i lidhur me organizatat e njohura terroriste ose është i përfshirë në aktivitete terroriste;
- Pronari përfitues i llogarisë nuk identifikohet si duhet;
- Përdorimi i llogarive të të nominuarve, trusteeve, anëtarëve të familjes apo palëve të treta;
- Përdorimi i identitetit të rremë;
- Abuzimi me organizatat jo-fitimprurëse;
- Përdorimi i fondeve nga organizata jo-fitimprurëse, nuk është në përputhje me qëllimin për të cilin ajo është themeluar;
- Transaksioni nuk justifikohet ekonomikisht dhe nuk përputhet me biznesin ose profesionin e mbajtësit të llogarisë;
- Kryerja e një sërë transfertash të komplikuara të fondeve nga një person tek tjetri, si një mjet për fshehur burimin dhe qëllimin e përdorimit të fondeve;
- Transaksionet të cilat nuk janë në përputhje me aktivitetin normal të llogarisë;
- Strukturimi i depozitimeve për të shmangur detyrimet e raportimit;
- Transaksione të shpeshta në ATM vendase apo ndërkombëtare;
- Depozita të parave fizike të shumta dhe në shuma të vogla në një llogari bankare, të shoqëruara nga transfertat drejt një vendi tjetër;
- Përdorimi i shumë llogarive bankare të huaja.

Shtojca 2. Formati i kërkesës për qasjen në fonde dhe pasuri

KËRKESË

Drejtuar:

Ministrit të Financave

Lënda: Kërkesë për autorizimin e shpenzimeve nga fondet dhe pasuritë e sekuestruara/nën bllokim, në përputhje me Nenin 23 të ligjit Nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi.

I nënshkruari/ I autorizuari:

Emri dhe Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Vendbanimi: _____

Numri i identitetit (ID): _____

Statusi ligjor: Person i shpallur/ subjekt i listuar sipas vendimit nr. ____, datë ____

Përfaqësuesi ligjor (nëse ka):

Emër/Mbiemër: _____

Numër i licencës së avokatit: _____

Kontakti: _____

Përmbajtja e kërkesës:

Në cilësinë e personit të shpallur dhe në përputhje me dispozitat e Nenit 23 të ligjit Nr.157/2013 përkatës, kërkoj autorizimin e përdorimit të fondeve të mia të sekuestruara për qëllime jetësore dhe të domosdoshme, si më poshtë:

1. Nevoja mjekësore personale/familjare:

- Përshkrimi i shpenzimit: _____
- Vlera: _____ Lekë
- Dokumentacion mbështetës: [fatura, referime mjekësore, etj.]

2. Detyrime shtetërore apo të sigurimeve të detyrueshme:

- Lloji i detyrimit: _____
- Vlera: _____ Lekë
- Afati i pagesës: _____

3. Nevoja të tjera personale/familjare të justifikuara ligjërisht:

- Përshkrimi: _____
- Vlera: _____ Lekë
- Dokumentacion mbështetës: _____

Bashkëlidhur me këtë kërkesë, dorëzoj:

- Kopje të dokumentit identifikues
- Dokumentacioni mjekësor/ligjor/fiskal përkatës
- Çdo informacion tjetër të kërkuar nga aktet nënligjore të Ministrisë
- Deklaratë e nënshkruar për vërtetësinë e të dhënave

Deklaratë:

Deklaroj se kjo kërkesë është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara dhe aktet zbatuese përkatëse në Republikën e Shqipërisë. Jam i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të rreme.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

Shtojca 3. Pyetje të shpeshta

1. Në cilësinë e subjektit të ligjit PPP/FT, si mund të siguroj zbatimin efektiv të SSHM?

Zbatimi efektiv i SSHM, nga subjektet e ligjit PPP/FT mbështetet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit me klientët. Ky proces përfshin monitorim të vazhdueshëm të procesit dhe për këtë arsye subjekti duhet të ketë në dispozicion mekanizma për të përditësuar në vijimësi informacionin për listën e personave të shpallur dhe sisteme për të realizuar kontrollet përkatëse për transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit me klientët, për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe procesin për ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive nëse do të konstatohen raste të tilla si dhe raportimin në AIF.

Nëpërmjet këtyre masave subjekti duhet të sigurojë që klienti, pronari përfitues i tij apo persona të përfshirë në transaksione ose marrëdhënie biznesi të mos jetë një person i shpallur.

2. Çfarë duhet të bëj nëse subjekti im zotëron fonde apo pasuri që i përkasin një personi të shpallur?

Neni 10/1 i ligjit MKFT, përcakton qartë se subjektet, institucionet dhe personat e parashikuar në nenin 10, të këtij ligji, si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë, kanë detyrimin të ngrijnë përkohësisht fondet apo pasuritë e tjera të personave ose enteve të shpallura, në mënyrë të drejtpërdrejtë, sapo marrin dijeni për shpalljen nga strukturat përkatëse të KSKB, BE-ja organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. Çfarë sistemesh të teknologjisë së informacionit mund të përdor për verifikimin e sanksioneve sipas ligjit MKFT?

Sistemet e automatizuara të teknologjisë së informacionit konsiderohen si mjete efektive në procesin e zbatimit nga subjektet të detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë me sanksionet. Pritshmëria është që subjektet që kanë kapacitetet e nevojshme të kenë sisteme të tilla (p.sh institucionet financiare), përdorimi i tyre duhet të shoqërohet dhe me kontrolle shtesë që diktohen në zbatim të vigjilencës së duhur që realizohen manualisht.

Për subjektet me kapacitete njerëzore dhe teknike më të kufizuara (p.sh PBJF) duhet që kontrollet të realizohen manualisht në bazën e të dhënave të klientëve, të shoqëruara dhe me procedura rigoroze të trajnimit të punonjësve dhe përditësimit të informacionit për ndryshimet që kryhen në listën e personave të shpallur.

Vlerësimi i nevojave të teknologjisë së informacionit është në diskrecionin e subjektit të ligjit.

4. Çfarë është pronësia dhe kontrolli përfitues i subjekteve të shpallura?

Në funksion të zbatimit efektiv të SSHF, pronësia përfituese dhe kontrolli i subjekteve të shpallura, nënkupton jo vetëm identifikimin e emrave personave apo subjekteve të listuar në mënyrë të qartë në listat e sanksioneve (KSKB, BE apo listat kombëtare), por edhe i çdo personi juridik që është

në pronësi ose kontrollohet prej tyre. Kjo masë siguron që zbatimi efektiv i sanksioneve nuk mund të anashkalohet përmes filialeve, kompanive fiktive ose përfaqësuesve.

Pronari përfitues i referohet personit fizik që ushtron kontrollin e fundit efektiv nëpërmjet zotërimit ose kontrollit të një subjekti juridik. Në kontekstin e SSHF, nëse një person i shpallur zotëron një pjesë të caktuar (p.sh., 25% ose më shumë) të një subjekti, ai konsiderohet gjithashtu i shpallur. Pronësia përfituese mund të ushtrohet gjithashtu dhe në mënyrë indirekte (p.sh. nëpërmjet zinxhirëve të pronësisë, personave të emëruar ose trusteve).

Koncepti i kontrollit shkon përtej aksioneve të zotëruara. Një person i shpallur mund të ushtrojë kontroll përmes:

- Të drejtave të votës (p.sh., të kesh shumicën e votave).
- Emërimit të administratorëve apo nivelit të lartë drejtues.
- Marrëveshjeve kontraktuale (p.sh., marrëveshjeve që u japin atyre ndikim vendimtar).
- Ndikimit *de facto* (ku një person i caktuar drejton strategjinë e biznesit edhe pa pronësi formale).

5. A ka platforma apo sisteme të teknologjisë së informacionit për SSHM të cilat njihen, rekomandohen apo miratohen zyrtarisht nga AIF?

AIF nuk rekomandon apo miraton platforma të tilla dhe nënvizon faktin që një vendimmarrje e tillë i përket vetë subjektit të tij, i cili duhet në çdo rast të sigurohet që platforma e përzgjedhur siguron zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore të SSHM dhe mundëson kontrollin e vazhdueshëm të transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit për tu siguruar që nuk përdoren nga personat e shpallur apo persona apo subjekte të lidhur me ta.

6. Çfarë janë mallrat me përdorim të dyfishtë

Mallrat me përdorim të dyfishtë shërbejnë si për qëllime civile ashtu edhe për ushtarake në industri të ndryshme. Në vijim paraqiten disa shembuj të mallrave të tillë.

- Elektronikë: Mikroprocesor dhe pajisjet kompjuterike me performancë të lartë të përdorura në produktet e konsumit dhe sistemet e përparuara ushtarake;
- Kimikate: Disa kimikate bujqësore dhe farmaceutike, luajnë gjithashtu një rol në prodhimin e armëve kimike;
- Siguria kibernetike: Programe të projektuara për të mbrojtur rrjetet kompjuterike mund të shfrytëzohet gjithashtu, për të dëmtuar ose kompromentuar sisteme të tjera;
- Avionët pa pilot: Pajisje që përdoren për qëllime tregëtar mund të përshtaten për mbikëqyrje dhe zbulim ushtarake;
- Hapësira ajrore dhe detare: Teknologjitë e zhvilluara (p.sh. GPS) për aviacionin civil ose lundrimin shpesh gjejnë përdorim në avionë ushtarakë dhe armë të drejtuara me precizion;
- Bioteknologjia: Kërkimet mjekësore dhe produktet bioteknologjike në fushën e kujdesit shëndetësor mund të ripërdoren gjithashtu për qëllime të luftës biologjike.

Të kuptuarit e mallrave me përdorim të dyfishtë është kritik për subjektet për të parandaluar kontributet e paqëllimshme në kërcënimet e sigurisë ose shkeljet e paqes ndërkombëtare. Subjektet duhet të jenë të informuar për implikimet e produkteve dhe teknologjive të tyre, përtej përdorimit të tyre të synuar.